

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË–Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me bashkëpunëtorin profesional Driton Sadiku, në lëndën penale kundër të pandehurit A.M. nga Gj., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga nenin 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II.nr.1732/2018, të datës 24.12.2018, për dhënien e urdhrorit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 15.02.2019 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A.M., nga i ati R., e ëma S., e gjinisë D., data e lindjes ... në Gj., ku edhe tani banon në rr. “.....” nr...., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, me profesion mekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal:

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 29.10.2018, rreth orës 16:20, duke drejtuar automjetin e tipit “....”, me targa te regjistrimit ... në rrugën “....” në drejtim të rrugës “....”, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 53 lidhur me nenin 255 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor Nr., dhe vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë nga pakujdesia, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se me një veprim të tillë do të vije deri te pasoja e ndaluar, lehtas ka marrë se gjerë tek ajo nuk do të vije apo në momentin e duhur do t’i shmanget, dhe pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që duke mos ja përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave në rrugë pasi që ka qenë koha me shi dhe rruga e lagur nga pakujdesia shkaktonte aksidentin trafikun, humb kontrollin ndaj automjetit duke ju sjellë automjeti në rrugë, duke u bartur në shiritin e kundërt qarkullues e që në atë momentin nga drejtimi i kundërt ka ardhur automjeti “P.” me targa të regjistrimit ...-... të cilin e drejtonte V.I. nga Gj., ku me pjesën e parë anësore të anës së djathtë e godet në pjesën ballore veturën e të dëmtuarit, ku përpos dëmeve materiale, dëmtime trupore kanë pësuar F.S. dhe G. B., lëndime këto të konstatuara dhe të përshkruara më hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. N.U. të datës 07.12.2018.

Me këto veprime ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 495 të KPP-së, jep këtë:

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti Përgjithshëm, për dhënien e urdhrorit ndëshkimor PP/II.nr.1732/2018, të datës 24.12.2018.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 4, 41, 43 par.1 pika 1.3, nenit 46, 73, 74 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit ia shqipton:

Në lartësinë prej 300 (treqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi atëherë dënimi me gjobë të pandehurit i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

Të dëmtuarit: V.(S.) I., G. B. nga Gj., me vendbanim në rr.”...” nr... dhe F. S. me vendbanim në fshatin Rr., Komuna e Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i pandehuri që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 51.10 Euro, për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 50 Euro, si dhe shpenzimet e paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë–Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.1732/2018, të datës 24.12.2018, kundër të pandehurit A.M. nga Gj., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga nenin 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-së dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë nga: deklarata e të dëmtuarit V.I., e dhëna në Stacionin Policor në Gjakovë me datë 29.10.2018, raporti i mbi vend shikimin e aksidentit të trafikut me nr....., të datës 29.10.2018 së bashku me skicën e vendit të ngjarjes e datës 29.10.2018, raporti mjekësor i Spitalit Rajonal “I. G.” në Gjakovë për të dëmtuarit, V.I. me nr....., të datës 29.10.2018, F.S. me nr..., të datës 29.10.2018 dhe G.B. me nr....., të datës 29.10.2018, ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. N. U. e datës 07.12.2018, ekspertiza e aksidentit të komunikacionit e Ingj. B. P., e datës 08.12.2018, deklaratat e të pandehurit A. M. e dhëna në Stacionin Policor në Gjakovë me datë 29.10.2018, foto-dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë u vërtetua se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, që në të ardhmen i pandehuri të mos kryej ndonjë vepër penale të paraparë me ligj.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale edhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 par.1 dhe par.2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë, në kuptim të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.912/18, me datë 15.02.2019

Bashkëpunëtori profesional,
Driton Sadiku

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Nëse i pandehuri nuk parashtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.